



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I LARTE GJYQESOR
DEPARTAMENTI I PROGRAMIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË BUXHETIT
DREJTORIA E PROGRAMIMIT DHE MONITORIMIT TË BUXHETIT

RAPORTI

I

MONITORIMEVE PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2022 PËR SISTEMIN GJYQËSOR

Me ligjin nr. 115/2021, datë 16.12.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, është miratuar buxheti i shtetit për vitin 2022, pjesë e të cilit është edhe buxheti për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor”. Fondet buxhetore të këtij grupi buxhetor, për vitin 2022, janë miratuar në tre programe buxhetore;

1. Programi buxhetor 01110, “**Planifikim, Menaxhim dhe Administrim**”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Programi buxhetor 01140, “**Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë**”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 972, datë 02.12.2020 “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”.
3. Programi buxhetor 03310, “**Buxheti Gjyqësor**”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së gjykatave në të tre nivelet.

1. Qëllimi kryesor për programin “**Planifikim, menaxhim dhe administrim**” është “Përmirësimi i sistemit gjyqësor nëpërmjet vendimarrjes së Këshillit lidhur me miratimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjeve që përbëjnë paketën e reformës në drejtësi si dhe sigurimin e burimeve dhe kapaciteteve financiare të nevojshme”.

Për realizimin e këtij qëllimi është përcaktuar objektivi: “KLGJ-ja do të angazhohet në vendosjen e standardeve të larta të kapaciteteve njerëzore dhe institucionale të saj si dhe për përmirësimin e performancës së gjyqësorit në të tre nivelet” me tregues performance:

1. Akte nënligjore të hartuara dhe miratuara nga KLGJ-ja kundrejt totalit të vendimeve të marra, në masën 75%.
2. Përqindja e punonjësve të KLGJ-së së trajnuar në masën 60%.
3. Përqindja e stafit administrativ dhe administrativ gjyqësor të rekrutuar në masën 80%.

4. Magjistratë të vlerësuar kundrejt totalit të magjistratëve në masën 70%.
5. Numri i magjistratëve të emëruar, transferuar, promovuar dhe shkarkuar kundrejt totalit të përgjithshëm të magjistratëve në masën 60%.
6. Përqindja e gjykatave të audituara, rreth 80% e tyre.

Për realizimin e këtyre treguesve janë përcaktuar 3 produktet e mëposhtme:

Produkti 92901AA - “Auditime të kryera”

Produkti M290072 - “Blerje Pajisje”

Produkti 18AD805 - “Programe Software”.

2. Programi buxhetor “**Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë**” ka për qëllim: “Përcaktimin e prioriteteve, politikave dhe standardeve, në lidhje me sistemet e teknologjisë së informacionit në sistemin e drejtësisë”.

Për realizimin e këtij qëllimi është përcaktuar si objektiv “Angazhimi i QTI-së, për garantimin e arritjes së standarteve të BE-së për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit” me tregues performance: “Përmirësimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit në sistemin e drejtësisë në masën 65%”.

Për realizimin e këtij treguesi është planifikuar për këtë program, produkti:

Produkti 92903AA - “Programe dhe pajisje të STI-së”.

3. Qëllimi kryesor për programin “**Buxheti Gjyqësor**” është: “Ofrimi efikas i shërbimeve dhe punë më e mirë në gjykatat e 3 niveleve”

Për realizimin e këtij qëllimi është përcaktuar si objektiv; “Të përmirësohet ofrimi i shërbimeve përmes novacionit dhe forcimit të strukturave dhe sistemeve të teknologjisë, që zhvillojnë koherencën , efikasitetin dhe efektshmërinë institucionale”, me tregues performance:

1. Përmirësimi, ose ngritja e sistemeve të teknologjisë së informacionit, të cilat përmbushin standardet ndërkombëtare dhe rrisin efikasitetin në ofrimin e shërbimeve, sipas ritmeve të ndryshimeve teknologjike, në masën 96%.

2. Vlerësimi dhe përmirësimi i infrastrukturës gjyqësore (ndërtesa, mjedise pune), për të garantuar standarde bashkëkohore në përmbushjen e detyrave kushtetuese dhe ofrimin dinjitoz të shërbimit për publikun, në masën 65%.

Për realizimin e këtyre treguesve janë përcaktuar 7 produktet e mëposhtme:

1- Produkti: 92902AA “Çështje të gjykuara”

2- Produkti: M290066 “Studime dhe projekte”

3- Produkti: 21AC501 “Programe software”

4- Produkti: M290068 “Ndërtim i ri dhe rikonstrukcion i plotë”

5- Produkti: 18AD801 “Blerje pajisje zyre ”

6- Produkti: 21AC401 “Blerje pajisje”

7- Produkti: M290075 “Blerje mjete motorike”

Në vijim jepen të dhëna për realizimin e fondeve buxhetore për sistemin gjyqësor për vitin 2022.

Aneksi nr.1 – Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve, për vitin 2022.


Pasqyra e raportit të shpenzimeve sipas programeve

000/ lekë

Programi	Buxheti i fillimit të vitit 2022	Buxheti i rishikuar vjetor 2022	Realizimi vjetor	% e realizimit kundrejt planit të periudhës raportuese
01110	296,208	274,316	249,357	91%
01140	8,840	4,544	2,106	46%
03310	3,454,760	3,199,866	2,982,492	93%
Totali	3,759,808	3,478,726	3,233,955	93%

Grafiku i raportit të shpenzimeve sipas programeve

000/lekw



Buxheti i miratuar me ligjin 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, për të tre programet buxhetore në fillim të vitit ishte **3,759,808 mijë lekë**, i detajuar përkatësisht:

- Programi 01110 - “Planifikim, menaxhim dhe administrim” në vlerën **296,208 mijë lekë**.
- Programi 01140 - “Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë”, në vlerën **8,840 mijë lekë**.
- Programi 03310 - “Buxheti Gjyqësor” në vlerën **3,454,760 mijë lekë**.

Gjatë vitit 2022, buxheti i grupit buxhetor është rishikuar si më poshtë:

1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë me Udhëzimin Plotësues nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, ka miratuar çeljen e fondit të veçantë për grupin buxhetor

Këshillin e Lartë Gjyqësor në vlerën **4,500 mijë lekë**. KLGJ me shkresën nr. 1181, datë 24.02.2022, drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ka kërkuar detajimin e këtij fondi në:

- Programi 01110 - “Planifikim, menaxhim dhe administrim” në vlerën **1,200 mijë lekë**.
- Programi 01140 - “Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë”, në vlerën **100 mijë lekë**.
- Programi 03310 - “Buxheti Gjyqësor”, në vlerën **3,200 mijë lekë**.

Ministria e Financave me shkresën nr. 3835/1, datë 10.03.2022, ka miratuar këtë detajim.

2. Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr 4934/3, date 17.03.2022, ka përcjellë pakësimin e fondit për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor”, mbështetur në Aktin Normativ nr. 3, datë 12.03.2022, në vlerën totale **130,152 mijë lekë**. Nga të cilat; **18,162 mijë lekë** në programin 01110, “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, **397 mijë lekë** në programin 01140 “Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë”, dhe **111,594 mijë lekë** në programin 03310 - “Buxheti Gjyqësor”.
3. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 2129/1, datë 18.02.2022, ka miratuar kërkesën e përcjellë nga KLGJ-ja me shkresën nr. 5801/1, datë 03.02.2022 për akordimin e fondit shtesë për kryerjen e pagesës pas ndërprerjes së funksionit të fundit, për tre ish anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor në vlerën **1,542 mijë lekë**. Vlerë, e cila u akordua në artikullin 606 “Transferta për tek ndividët”, të programit 01110 të KLGJ-së.
4. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 4306/1, datë 07.04.2022, ka miratuar kërkesën e përcjellë nga KLGJ-ja me shkresën nr. 1325, datë 03.03.2022 për akordimin e fondit shtesë për kryerjen e pagesës pas ndërprerjes së funksionit të fundit, për dy ish anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor në vlerën **1,028 mijë lekë**. Vlerë, e cila u akordua në artikullin 606 “Transferta për tek individët”, të programit 01110 të KLGJ-së.
5. Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr 14405/108, datë 29.08.2022, ka përcjellë pakësimin e fondit për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor”, mbështetur në Aktin Normativ nr. 12, datë 29.07.2022, në vlerën totale **25,000 mijë lekë**. Nga të cilat; **5,000 mijë lekë** në programin 01110, “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, dhe **20,000 mijë lekë** në programin 03310 - “Buxheti Gjyqësor”.
6. Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr 22351/130, date 05.01.2023, ka përcjellë pakësimin e fondit për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor”, mbështetur në Aktin Normativ nr. 17, datë 01.12.2022, në vlerën totale **133,000 mijë lekë**. Nga të cilat; **2,500 mijë lekë** në programin 01110, “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, **4,000 mijë lekë** në programin 01140 “Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë”, dhe **126,500 mijë lekë** në programin 03310 - “Buxheti Gjyqësor”.

Buxheti i rishikuar vjetor për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor”, pas ndyshimeve të mësipërme është **3,478,726, mijë lekë**, ndërsa realizimi vjetor është **3,232,955 mijë lekë** ose në masën **93%**, të rakorduara edhe me sistemin SIFQ) përkatësisht:

- Programi 01110 - “Planifikim, menaxhim dhe administrim” plani i rishikuar vjetor është **274,316 mijë lekë**, ndërsa realizimi është **249,357 mijë lekë** ose në masën **91%**

- Programi 01140 - “Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë” Plani i rishikuar vjetor është **4,544 mijë lekë**, ndërsa realizimi është **2,106 mijë lekë**, ose në masën **46%** .
- Programi 03310 - “Buxheti Gjyqësor” plani i rishikuar vjetor është **3,199,866 mijë lekë**, ndërsa realizimi vjetor është **2,982,492 mijë lekë**, ose në masën **93%**. Të rakorduara edhe me sistemin SIFQ.

Përveç fondeve buxhetore gjykatat në zbatim të V.K.M nr. 432, datë 08.06.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave dytësore që krijojnë institucionet buxhetore”, si dhe Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë të Drejtësisë nr. 33 datë 29.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore”, kanë përdorur edhe të ardhurat e krijuara prej tyre. Për vitin 2022, realizimi i shpenzimeve nga të ardhurat jashtë limitit (vetëm programit 03310 - Buxheti Gjyqësor) është **23,585 mijë lekë** (të rakorduara edhe me sistemin SIFQ).

Në mënyrë më të detajuar të dhënat për të 3 programet paraqiten në aneksin nr.2.

Aneksi nr.2 -Raporti i shpenzimeve të programeve, sipas artikujve për vitin 2022

I- Programi - 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim”

Programi - 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim”

000/lekë

<i>Emërtimi</i>	<i>Buxheti i fillimit të vitit 2022,</i>	<i>Buxheti i rishikuar vjetor 2022</i>	<i>Realizimi për vitin 2022</i>	<i>% e realizimit për vitin 2022</i>
Shpenzime korrente Art (600+601+602+606)	281,208	261,816	238,507	91%
Investime Art.(230+231)	15,000	12,500	10,849	87%
Totali	296,208	274,316	249,357	91%

Buxheti i alokuar me ligjin e buxhetit për Këshillin e Lartë Gjyqësor në këtë program, në fillim të vitit 2022, ishte **296,208 mijë lekë**. Buxheti i rishikuar vjetor sipas akteve ligjore të mësipërme është **274,316 mijë lekë**; nga të cilat **261,816 mijë lekë** në shpenzime korrente dhe **12,500 mijë lekë** në investime.

Realizimi faktik për periudhën raportuese është **249,357 mijë lekë** ose në masën **91%** të buxhetit të rishikuar të periudhës raportuese (të rakorduara edhe me sistemin SIFQ).

“**Artikulli 600 + 601**” - Buxheti vjetor i alokuar në “*Shpenzime personeli*” për këtë program në fillim të vitit ishte **216,000 mijë lekë**. Gjatë vitit përveç pakësimit të fondit me aktet ligjore të sipër cituar, janë kryer edhe rialokime fondi brenda të njëjtit program nga një artikull buxhetor në një tjetër.

- Me kërkesë të KLGJ-së, me shkresën nr. 721, datë 04.02.2022 drejtuar MFE-së, u kërkua transferim i fondit (pakësimi) në vlerën **5,000 mijë lekë** nga shpenzime personeli (Art

600+601), dhe transferimi (shpresë) në shpenzime operative (Art.602).Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 2128/1, datë 10.02.2022, ka miratuar këtë transferim.

- Në muajin dhjetor në zbatim të VKM-së, nr. 898, datë 29.12.2022 "Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme dhe Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik", fondi në vlerën **1,440, mijë lekë** u transferua nga ky artikull në artikullin 606 me qëllim kryerjen e pagës së mbështetjes financiare në zbatim të vendimit të mësipërm, për punonjësit e KLGJ-së.

Buxheti i rishikuar vjetor është **199,160 mijë lekë**, ndërsa realizimi vjetor është **193,257mijë lekë** ose në masën **97 %** (të rakorduara edhe me sistemin SIFQ). Në fillim të vitit 2022, numri i strukturës organizative të Këshillit të Lartë Gjyqësor rezultonte 125 punonjës. Me Vendimin Nr. 72, datë 23.02.2022 të KLGJ, "Për detajimin e numrit të punonjësve për vitin 2022", janë detajuar 3 pozicione shpresë në strukturën organizative, duke bërë që numri i strukturës aktuale të jetë 128 pozicione. Në fund të muajit dhjetor 2022, numri i strukturës organizative të Këshillit të Lartë Gjyqësor rezulton të jetë 128 punonjës, ndërsa organika faktike është 106 punonjës, ose 82.8% (e numrit total). Mungesat në total janë 22 vakanca, të cilat kanë ndikuar në masën e realizimit të këtij artikulli.

"Artikulli 602" - Buxheti vjetor i alokuar në *"Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera"* për këtë program ishte **63,808 mijë lekë**. Gjatë vitit buxhetor 2022 buxheti është pakësuar fondi në vlerën 12,762 mijë lekë me Aktin Normativ nr. 3, datë 12.03.2022, dhe është shtuar fondi në vlerën **5,000 mijë lekë**, me shkresën e sipërcituar të KGJ-së nr.721 datë 04.02.2022 miratuar nga MFE me shkresën nr. 2128/1, datë 10.02.2022.

Buxheti i rishikuar vjetor si rezultat i ndryshimeve është **56,046 mijë lekë**, ndërsa realizimi vjetor është **40,450 mijë lekë** ose në masën **72%** (të rakorduara edhe me sistemin SIFQ). Fondi ka shërbyer për plotësimin e nevojave të stafit të KLGJ-së me materiale e shërbime zyre si dhe janë kryer likuidimet e shpenzimeve të shërbimeve ndaj të tretëve, etj. Janë likuiduar kontratat vjetore për shërbim printimi dhe fotokopjimi si dhe shërbim mirëmbajtje automjetesh, blerje goma bateri, shërbime pritje përcjellje, shërbim larje makine në përputhje me kushtet kontraktuale. Mosrealizimi ka të bëjë me faktin që disa nga nënzëra të këtij artikulli nuk janë realizuar plotësisht

"Artikulli 606" - Buxheti vjetor i alokuar në *"Transferta për Buxhetet Familjare dhe Individë"* për programin 01110 "Planifikim, menaxhim dhe administrim" për vitin 2022, është **6,610 mijë lekë**. Fondi përfshin :

- Fondin e veçantë në vlerën **1,200 mijë lekë**, i miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 3835/1 , datë 10.03.2022.

- Fondin në vlerën **1,400 mijë lekë**, i cili do të përdoret për kryerjen e kompesimeve të shpenzimeve të telefonisë celulare, për anëtarët e KLGJ-së dhe disa punonjës të nivelit drejtues të administratës, në zbatim të pikës nr. 5 të Udhëzimit Plotësues nr. 1, datë 10.01.2022, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022".


- Fondin në vlerën totale **2,570 mijë lekë** (1,542 mijë lekë +1,028 mijë lekë), i akorduar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë respektivisht me shkresat nr. 2129/1, datë 18.02.2022 dhe 4306/1, datë 07.04.2022, mbështetur në kërkesat e paraqitura nga KLGJ-ja. Fondi është përdorur

për kryerjen e pagesës pas ndërprerjes së funksionit të fundit, për 5 ish anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

- Shtesë fondi në vlerën **1,440, mijë lekë** i transferuar nga artikulli 600 “pagat”, në këtë artikull, në zbatim të VKM-së, nr. 898, datë 29.12.2022 "Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme dhe Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik", me qëllim kryerjen së pagesës së mbështetjes financiare në zbatim të vendimit të mësipërm, për punonjësit e KLGJ-së . Gjatë vitit 2022, është përdoruar fondi në vlerën **4,800 mijë lekë, ose 73 % e tij.**

“**Artikulli 231**” - Buxheti vjetor për shpenzime kapitale, në këtë program, ishte **15,000 mijë lekë**. Gjatë vitit buxhetor ky fond është rishikuar. Në zbatim të Aktit Normativ nr.17 datë 01.12.2022, fondi u pakësua në vlerën **2,500 mijë lekë**. Buxheti i rishikuar vjetor është **12,500 mijë lekë**, ndërsa realizimi është **10.849 mijë lekë** ose në masën **87%**. Fondi është i detajuar në dy projekte konkretisht;

Paraqitja grafike e detajimit të fondit të investimeve per vitin 2022, programi 01110



- **Produkti M290072** (Blerje pajisje) ; Fondi në vlerën **11,757 mijë lekë**, u përdor për plotësimin e nevojave të KLGJ-së me;
 - **“Instalim dhe pajisje telekomunikacioni”** (Server).
 - **“Pajisje të tjera teknike”** (Switch Layer 3, Storage për server, Firwall, aksesorë, etj).
 - **“Pajisje kompjuterike”** (Kompjuter, laptop).
 - **Blerje libra-fond biblioteke”** (Libra dhe kode të jurisprudencës).
 - **“Orendi zyre”**, të cilat u përdoren për blerjen e pajisjeve dhe orendive të zyrave, etj, duke u bazuar në nevojat e identifikuar për këto shpenzime,
 - **“Pajisje të tjera zyre”**, të cilat do të përdoren për blerjen e pajisjeve të ndryshme të zyrave, si scanner, grirëse letre, diktofon, sëitch, kamera, aparat fotografik, etj,Fondi është realizuar në vlerën 10,107 mijë lekë ose në masën 86% . Diferenca është tepriçë nga prokurimet online.

- **Produkti 18AD805** “Programe software ”, në vlerën **743 mijë lekë**, për blerje (Programe software, patenta) për ristrukturimin e portalit të KLGJ-së. Fondi është realizuar plotësisht në vlerën 743 mijë lekë ose në masën 100%.

II- Programi - 01140 “Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë”

Programi - 01140 “Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë”

000/lekë

<i>Emërtimi</i>	<i>Buxheti i fillimit të vitit 2022</i>	<i>Buxheti i rishikuar vjetor 2022</i>	<i>Realizimi për vitin 2022</i>	<i>% e realizimit për vitin 2022</i>
Shpenzime korrente Art (600+601+602+606)	8,840	4,544	2,106	46%
Totali	8,840	4,544	2,106	46%

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 972, datë 02.12.2020 “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”, pika 4 citon se, “Qendra financohet nga buxheti i shtetit si një program buxhetor i veçantë në buxhetin e përgjithshëm të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Fondi i akorduar në fillim të vitit si pjesë përbërëse e grupit buxhetor, Këshilli i Lartë Gjyqësor, për këtë program është **8,840 mijë lekë**. Buxheti i rishikur vjetor si rezultat i zbatimit të Akteve ligjore të mësipërmë në vlerën **4,544 mijë lekë** është i detajuar tërësisht në shpenzime korrentë nga të cilat; **3,328 mijë lekë** në shpenzime personeli dhe **1.216 mijë lekë** në shpenzime operative (ART.602+606). Realizimi për këtë program është 2,106 mijë lekë ose në masën 46% (të rakorduar edhe me sistemin SIFQ).

“**Artikulli 600 + 601**” - Buxheti vjetor i alokuar në “*Shpenzime personeli*”, për këtë program në fillim të vitit është **6,500 mijë lekë**. Buxheti gjatë vitit 2022 është pakësuar me Aktet ligjore të mësipërme po edhe brenda për brenda programit është bërë një transferim fondi.

- Pakësuar fondi në vlerën 10 mijë lekë dhe transferuar kjo vlerë në “*Transferta për Buxhetet Familjare dhe Individë*” (artikullin 606) në zbatim të VKM-së, nr. 898, datë 29.12.2022 "Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme dhe Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik", me qëllim kryerjen e pagësës së mbështetjes financiare në zbatim të vendimit të mësipërm, për punonjës të QTI-së’

Buxheti i rishikuar vjetor në “*Shpenzime personeli*”, është **3,328 mijë lekë** ndërsa realizimi vjetor është **1,814 mijë lekë** ose në masën **54.5%** (të rakorduara edhe me sistemin SIFQ). Numri i punonjësve të QTI-së i miratuar me ligj për vitin 2022, është **6** punonjës, ndërsa aktualisht është punësuar vetëm 1 punonjës (Drejtori i QTI-së), ose 16.7% e numrit total, pra ka një mungesë me **5** punonjës, e cila ka ndikuar në masën e realizimit të këtij artikulli.

“**Artikulli 602**” - Buxheti i rishikuar vjetor i alokuar në “*Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera*” është **1,106 mijë lekë**. Realizimi vjetor është **282 mijë lekë** ose në masën 25.4%. Fondi nuk është realizuar plotësisht, pasi, QTI po funksion me kapacitet jo të plotë, vetëm me 1 punonjës.

“**Artikulli 606**” - Buxheti vjetor i alokuar në “*Transferta për Buxhete Familjare dhe Individë*” për këtë program është **110 mijë lekë**, (100 mijë janë fonde të detajuar në fillim të vitit, kurse 10 mijë është fondi i transferuar) në zbatim të VKM-së, nr. 898, datë 29.12.2022. Fondi është realizuar në vlerën 10 mijë lekë, ose në masën 9%.

III - Programi - 03310 “Buxheti Gjyqësor”

Programi - 03310 “Buxheti Gjyqësor”

<i>Emërtimi</i>	<i>Buxheti i fillimit të vitit 2022</i>	<i>Buxheti i rishikuar vjetor 2022</i>	<i>Realizimi për vitin 2022</i>	<i>% e realizimit për vitin 2022</i>
Shpenzime korrente Art 600+601+602+606	3,057,760	2,827,366	2,659,597	94%
Investime Art.(230+231)	397,000	372,500	322,894	87%
Totali	3,454,760	3,199,866	2,982,492	93%

Fondi i akorduar për këtë program me ligjin e buxhetit 115/2021, ishte **3,454,760 mijë lekë**.

Buxheti i rishikuar vjetor pas zbatimit të akteve ligjore të sipërcituar për këtë program është **3,199,866 mijë lekë**, i ndarë në **2,827,366 mijë lekë** për shpenzime korrente dhe **372,500 mijë lekë** për shpenzime kapitale.

Realizimi vjetor është **2,982,492 mijë lekë**, ose në masën **93%** (të rakorduara edhe me SIFQ). Në mënyrë të detajuar për çdo artikull situata paraqitet si më poshtë:

“**Artikulli 600 + 601**” - Në “*Shpenzime personeli*”, buxheti vjetor i alokuar për këtë program ishte **2,582,760 mijë lekë**. Gjatë viti 2022, buxheti në “*Shpenzime personeli*” është rishikuar me aktet ligjore të sipërcituara, por për të plotësuar nevojat që kanë patur gjykatat, KLGJ-ja, ka bërë edhe disa rishpërndarje fondesh ndërmjet artikujve të këtij programi.

- Me shkresën e KLGJ-së nr.721 , datë 04.02.2022, ju kërkua Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë transferimi i fondit në vlerën **79,750 mijë lekë**, nga zëri “*Shpenzime personeli*” në artikullin 602 “*Shpenzime operative*”, të këtij programi. Ky transferim ishte i lidhur me sistemin e detajimit të fondeve buxhetore në këto 2 artikuj në përputhje me vendimin nr. 495 të KLGJ për detajimin e fondeve buxhetore. Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr 2128/1, datë 10.02.2022, ka miratuar këtë transferim.

- Me shkresën e KLGJ-së nr. 3777, datë 01.07.2022, ju kërkua Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë transferimi i fondit në vlerën **27,750 mijë lekë**, nga zëri “*Shpenzime personeli*” në artikullin 602 “*Shpenzime operative*”, të këtij programi. Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr 13028/1, datë 14.07.2022, ka miratuar këtë transferim.

-Me shkresat e KLGJ-së nr. 5499 dhe nr 5500 të KLGJ datë 18.10.2022, fondi në tërësi u shtua në vlerën 6,600 mijë lekë (13,290 mijë në art, 600 dhe u pakësua art. 601 me 6,690 mijë lekë, Pakësuar artikulli 602 në vlerën 3,100 mijë lekë dhe artikulli 606 në vlerën 3,500 mijë lekë). Fondi ishte i nevojshëm për plotësimin e nevojave për kryerjen e pagesave për shpenzime

personeli në zbatim të VKM 621/2022 dhe 627/2022. MFE ka miratuar këtë transferim me shkresën nr.19222/1 datë 28.10.2022.

-Transferuar nga “shpenzime personeli” (artikulli 600) fondi në vlerën **17,800 mijë lekë**, në artikullin 606 “Transferta për Buxhete Familjare dhe Individë” në zbatim të VKM-së, nr. 898, datë 29.12.2022 "Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme dhe Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik", me qëllim kryerjen e pagesës së mbështetjes financiare në zbatim të vendimit të mësipërm, për punonjës të gjykatave.

Për sa më sipër buxheti i rishikuar vjetor në “Shpenzime Personeli”, është **2,287,491 mijë lekë**, ndërsa realizimi vjetor është **2,141,614 mijë lekë**, ose në masën **94%** (të rakorduara edhe me sistemin SIFQ).

Realizimi në këtë masë është i lidhur me mungesat në sistemin gjyqësor. Numri i punonjësve të Sistemit Gjyqësor i miratuar me ligj për vitin 2022, si dhe Vendimit Nr. 72, datë 23.02.2022 të KLGJ, “Për detajimin e numrit të punonjësve për vitin 2022”, është **1,729 vetë**. Nga këto; **1,595** vetë është organika e stafit gjyqësor, **128 vetë** janë punonjës të stafit të KLGJ-së dhe **6 vetë** është numri i punonjësve të QTI-së. Numri faktik në fund të vitit 2022, e sistemit gjyqësor është **1,482** punonjës ndërsa mungesat janë **247 punonjës** ose 14 % e stafit, si në pasqyrën më poshtë.

Pasqyra e organikës së sistemit të drejtësisë(KLGJ/QTI /Gjykatat)

<i>Institucioni</i>	<i>Struktura organizative</i>	<i>Nr. faktik</i>	<i>Diferenca</i>
KLJGJ	128	106	22
QTI	6	1	5
Gjykatat	1,595	1,375	220
Totali	1,729	1,482	247

Aktualisht në gjykata ka mungesa me **220** punonjës; nga të cilët **90** janë gjyqtarë (vakanca të përhershme)), dhe **130** janë punonjës të administratës. Përveç vakancave të përhershme janë edhe 90 magjistratë që i takojnë vakancave të përkohëshme, të cilët paguhen me 75% të pagës, pasi janë akoma në proces vlerësimit, gjë që ka ndikuar në masën e realizimit në këtë artikull.

“**Artikulli 602**” – Buxheti vjetor i alokuar në fillim të vitit në “Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera” ishte **470,250 mijë lekë**. Gjatë viti 2022 buxheti në këtë artikull është pakësuar në vlerën 57,025 mijë lekë me aktet ligjore të sipërcituara. KLGJ nisur nga nevojat e gjykatave ka kryer disa rishpërndarje fondesh si më poshtë :

- Me shkresën e KLGJ-së, nr. 721, datë 04.02.2022, miratuar nga MFE me shkresën nr. 2128/1 , datë 10.02.2022 shtesë fondi në vlerën **79,750 mijë lekë**.
- Me shkresën e KLGJ-së, nr. 3777 , datë 01.07.2022, miratuar nga MFE me shkresën nr 13028/1, datë 14.07.2022 shtesa e fondit në vlerën **27,750 mijë lekë**.
- Me shkresën nr 5499 të KLGJ date 18.10.2022, miratuar nga MF me shkresën 19222/1 datë 28.10.2022, pakësimi fondi në vlerën **3,100 mijë lekë**,

Buxheti i rishikuar vjetor është është **517,625 mijë lekë**, ndërsa realizimi faktik është **497,993 mijë lekë**, ose në masën **96%** (të rakorduara edhe me sistemin SIFQ). Buxheti u planifikua duke

u mbështetur në nevojat për shpenzime operative të gjykatave referuar kërkesave të përcaktuara në fazat e projektbuxhetit sipas zërave të shpenzimeve. Mbështetur në këto kërkesa gjatë vitit janë kryer shpenzime; për udhëtim e dieta në vlerën 9,907 mijë lekë, materiale shërbime zyre në vlerën 79,508 mijë lekë, shërbime ndaj të tretëve në vlerën 114,628 mijë lekë, shpenzime transporti 37,580 mijë lekë, shpenzime mirëmbajtje të zakonshme 104,262 mijë lekë, shpenzime të tjera speciale 152,108.4 mijë lekë. Pjesë e këtyrë shpenzimeve janë edhe fondet e detajuara në programin 03310 të KLGJ-së në vlerën 192,300 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 188.797 mijë lekë ose në masën 98%.

Artikulli është realizuar në vlerën **497,993 mijë lekë** ose në masën 96% duke patur një performancë të mirë për sa i takon përdorimit me efikasitet dhe efikasitet të fondeve buxhetore.

“Artikulli 606” - Buxheti vjetor i alokuar në *“Transferta për Buxhete Familjare dhe Individë”* në Buxhetin Gjyqësor për vitin 2022, është **22,250 mijë lekë**, nga të cilat:

- Fondi në vlerën **4,750 mijë lekë** është, miratuar nga KLGJ-ja për këtë grup shpenzimesh, dhe parashikohen të përdoren kryesisht për kryerjen e kompesimeve të shpenzimeve të telefonisë celulare për funksionarët përfitues në gjykata, si dhe lidhur me përfitimin e interesit të kredisë për blerje apartamenti për qëllime banimi për gjyqtarët, sipas parashikimeve ligjore.

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë me Udhëzimit Plotësues nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, ka akorduar fondin e veçantë për grupin buxhetor Këshillin e Lartë Gjyqësor në vlerën **4,500 mijë lekë**. KLGJ me shkresën nr. 1181, datë 24.02.2022, drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ka kërkuar detajimin e fondit sipas programeve. Ministria e Financave me shkresën nr 3835/1, datë 10.03.2022, ka miratuar këtë detajim.

- Transferuar (pakësuar) fondi në vlerën **3,500 mijë lekë**, me kërkesë të KLGJ-së dhe miratuar nga MFE me shkresën 19222/1 datë 28.10.2022.

- Shtesë fondi në vlerën **17,800 mijë lekë**, transferur nga artikulli 600 “ paga” në zbatim të VKM-së, nr. 898, datë 29.12.2022 "Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme dhe Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik", me qëllim kryerjen së pagësës së mbështetjes financiare në zbatim të vendimit të mësipërm, për punonjësit e stafit të gjykatave.

Gjatë viti 2022 për nevojat e gjykatave është përdorur fondi në vlerën **20,290 mijë lekë**, ose në masën **91%** (të rakorduara edhe me sistemin SIFQ).

“Artikulli 230+231”- Në *“Shpenzime kapitale”* për këtë program buxhetor në fillim të vitit 2022, ishin **397,000 mijë lekë**. Gjatë viti buxhetor fondi në investime është pakësuar me aktin normativ nr. 17, datë 01.12.2022, në vlerën 24,500 mijë lekë.

Buxheti i rishikuar vjetor në shpenzime kapitale në total për këtë program, është **372,500 mijë lekë** i detajuar **2,000 mijë lekë** në Artikullin 230 *“Shpenzime kapitale të patrupëzuara”* dhe **370,500 mijë lekë** në artikullin 231 *“Shpenzime kapitale të trupëzuara”*. Realizimi vjetor është **322,894 mijë lekë**, ose në masën **87%**.

Më poshtë po japim një pasqyrë sintetike të shpenzimeve në investime, pasi në mënyrë të detajuar ky zë do të analizohet në aneksin 5, të këtij raporti.


Artikulli 230 *“Shpenzime kapitale të patrupëzuara”*

Produkti **M290066** “ Studime dhe projektme fondi i planifikuar në vlerën 2,000 mijë lekë për realizimin e hartimi projektit për Gjykatën e Apelit Tiranë. Është realizuar plotësisht hartimi i projektit në vlerën 1,599 mijë lekë ose në masën **80%**. Diferenca, tepriçë nga prokurimi online.

Artikulli 231 “Shpenzime kapitale të trupëzuara” Buxheti i rishikuar vjetor është **370,500 mijë lekë**, është realizuar në vlerën **321,295 mijë lekë** i detajuar në 5 produkte si më poshtë:

Pasqyra e detajimit të fondeve në investime programi 03310,

000/lekë



1-Produkti 21AC501 “ Programe software” ; Fondi në vlerën **240,051 mijë lekë** përbëhet nga: fondi në vlerën **238,375 mijë lekë**, i detajuar në programin 03310 të KLGJ-së dhe 1,676 mijë lekë për Gjykatën e Lartë. Fondi u përdor për blerje Patenta, licenca, softëare etj. Fondi është realizuar në vlerën **203,185 mijë lekë** (nga të cilat **201,509 mijë lekë**, është realizimi i fondit të detajuar për KLGJ dhe **1,676 mijë lekë** është fondi i realizuar nga Gjykata e Lartë). Produkti është realizuar në masën **85%**.

2-Produkti M290068 “Ndërtim i ri dhe rikonstruksion i plotë ose i pjesshëm”

Buxheti i rishikuar vjetor në këtë produkt është **68,660 mijë lekë**. Buxheti ka shërbyer për kryerjen e punimeve në nivel mirëmbajtje për 3 gjykata: Gj e Lartë në 23,952 mijë lekë, Gj e Apelit Tiranë 22,800 mijë lekë dhe Gj. Rrethit Gjyqësor Tiranë 21,908 mijë lekë.

Fondi është realizuar në përputhje me objektin e prokurimit nga të tre gjykatat në vlerën **63,592 mijë lekë**, ose në masën **93%**.

3- Produkti 21AC401 “Blerje pajisje”- Buxheti i rishikuar vjetor është **26,445 mijë lekë** i detajuar për 21 gjykata. Fondi është realizuar në vlerën **19,247 mijë lekë** nga 20 gjykata, ose në masën **73%**. Gjykata e Lartë nuk e ka realizuar fondin pasi procedura e prokurimit të këtij fondi u anulua nga KPP.

4- Produkti 18AD801 “Blerje pajisje zyre”- Buxheti i rishikuar vjetor është është **23,140 mijë lekë** i detajuar për 22 gjykata dhe është realizuar nga 22 gjykatat në vlerën **23,068 mijë lekë** ose në masën **100%**.

5- Produkti M290075 “Blerje mjete motorike” - Buxheti i rishikuar vjetor është **12,204 mijë lekë**, ndërsa realizimi vjetor është **12,204 mijë lekë** ose në masën **100%**.

Për vitin 2022, gjykatat kanë realizuar shpenzime edhe nga të ardhurat e krijuara prej tyre. Në total janë kryer **23,585 mijë lekë** shpenzime nga të ardhurat, nga të cilat **18,285 mijë lekë** në shpenzime operative dhe **5,300 mijë lekë** në investime.

Aneksi nr. 3 - Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës /produkteve, për vitin 2022.

I - Programi - 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim”

Në funksion të objektivit të DPP-së, së këtij programi, për vitin 2022, janë përcaktuar 3 produkte,

1- **Produkti 92901AA** - “Auditime të kryera”.

2- **Produkti M290072** - “Blerje Pajisje”

3- **Produkti 18AD805** – “Blerje Softwarë”

Gjatë vitit 2022, mbështetur në vlerën e fondit të planifikuar për secilin produkt dhe njësisë matëse, shpenzimet mesatare për secilin produkt dhe ndryshimi i tyre gjatë vitit paraqitet si më poshtë:

Produkti 92901AA - “Auditime të kryera” - Njësia matëse - “nr.vendimesh.”

Në fillim të vitit mbështetur në politikën e programit, objektivat dhe stafin, u planifikuan rreth **600** vendime. Gjatë vitit janë realizuar **562** të tilla. Shpenzimet mesatare të këtij produkti për periudhën raportuese janë **424 mijë lekë/vendim**, kundrejt **469 mijë lekë/vendim** sipas planit të fillim vitit dhe **436 mijë lekë /vendim**, sipas planit të rishikuar vjetor. Për vitin 2022 shpenzimet mesatare për njësi në fund të viti kanë qënë 9% më të ulta së planifikimi fillestare dhe 3% më të ulta me planin e rishikuar.

Produkti M290072- “Blerje Pajisje” - Njësia matëse – nr. institucioni.

Shpenzimet mesatare të planifikuara për këtë produkt në fillim të vitit ishte në vlerën **14,600 mijë lekë** ndërsa sipas buxhetit të rishikuar vjetor janë **11,757 mijë lekë**. Shpenzimet e kryera për këtë produkt janë **10,107mijë lekë**. Shpenzimet mesatare për njësi të këtij produkti janë rreth 29% më të ulta në krahasim me shpenzimet mesatare të planifikuara në fillim të vitit dhe 14 % më të ulta se shpenzimet mesatare sipas buxhetit të rishikuar.

Produkti 18AD805– “Programe software” - Njësia matëse – nr. institucioni.

Shpenzimet mesatare për këtë produkt në fillim të vitit ishin **840 mijë lekë**, ndërsa sipas buxhetit të rishikuar është 743 mijë lekë, që është dhe vlera e realizimit të këtij produkti. Shpenzimet mesatare të planifikuara për njësi për këtë produkt gjatë realizimit të tij kanë mbetur të pandryshuara, kundrejt planit të rishikuar, ndërsa kundrejt planit të fillimit të vitit janë 12% më të ulta.

II- Programin 01140 “Mbështetje për teknologjinë, e sistemit të drejtësisë”

Me VKM-në nr. 972, datë 02.12.2020, fondet e nevojshme për funksionimin e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit (QTI), për vitin 2022, janë përfshirë në buxhetin e sistemit gjyqësor, në programin buxhetor 01140 “Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë” Produkti i vetëm për këtë program është “Programe dhe pajisje të STI” me kod projekti **92903AA**.

Produkti 18AD805 – “Programe dhe pajisje të STI” - Njësia matëse – nr. sistemesh

Shpenzimet mesatare të planifikuara në fillim të vitit në vlerën 8,840 mijë lekë janë rishikuar në vlerën 4,544 mijë lekë, ndërsa në fund të vitit shpenzimet mesatare janë 2,106 mijë lekë për njësi. Kjo ka sjellë që këto shpenzime në fund të vitit të jenë 76% më të ulta krahasuar me planin e fillim vitit dhe 54% më të ulta kundrejt planit të rishikuar vjetor .

III - Programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”

Në funksion të objektivit të DPP-së, janë përcaktuar për këtë program produktet e mëposhtme;

1. **Produkti: 92902AA** “Çështje të gjykuara”- Njësia matëse - nr. çështjesh.
2. **Produkti M29066** “ Studime dhe Projektme” ”- Njësia matëse - nr. projektesh.
3. **Produkti: 21AC501** “Programe Software”- Njësia matëse- nr. programesh.
4. **Produkti: M290068** “Ndërtim i ri dhe rikonstruksion i plotë” - Njësi matëse – nr.institucioni.
5. **Produkti: 21AC401** “Blerje pajisje” -Njësia matëse – nr.institucioni.
6. **Produkti:18AD801**“Blerje pajisje zyre ” -Njësia matëse – nr. institucioni.
7. **Produkti:M290075** “Blerje mjete motorike” -Njësia matëse – nr. mjetesh.

Gjatë vitit 2022 mbështetur në vlerën e fondit të planifikuar për secilin produkt dhe njësisë matëse, shpenzimet mesatare për secilin produkt dhe ndryshimi i tyre gjatë vitit paraqitet si më poshtë:

1- Produkti: 92902AA “Çështje të gjykuara”- Njësia matëse - nr. çështjesh.

Parashikimi i numrit të çështjeve nga ana e gjykatave është kryer referuar tendencës së numrit të çështjeve për disa vite si edhe në përputhje me situatën specifike në Sistemin Gjyqësor. Për shkak të mungesave në strukturat organike të gjykatave, është rritur ngarkesa e gjyqtarëve me gjykime, të cilat kanë çuar në zgjatjen e afatit të gjykimit.

Numri i çështjeve të parashikuara për vitin 2022, ishte **162,514 çështje**, shpenzimet e planifikuara për realizimin e tyre në fillim të vitit ishin **3,057,760 mijë lekë**, ndërsa sipas planit të rishikuar këto shpenzime janë **2,827,366 mijë lekë**. Gjatë vitit 2022 janë përfunduar **131,865 çështje** dhe për realizimin e tyre janë shpenzuar **2,659,597 mijë lekë**, ose **20 mijë lekë/çështje** kundrejt **17 mijë lekë/çështje** sipas planit të rishikuar vjetor. Kjo ka sjellë që shpenzimet mesatare për njësi të kenë pësuar një rritje në masën **16%**, krahasur me planin e fillimi të viti dhe **7%** krahasuar më planin e rishikuar.

2- Produkti: M290068 “Ndërtim i ri dhe rikonstruksion i plotë” - Njësia matëse – nr.institucioni.

Për vitin 2022, u planifikuan punime në nivel mirëmbajtje në 5 gjykata në vlerën **71,700 mijë lekë**, ose u planifikun mesatarisht për kryerjen e punimeve **14,340 mijë lekë /institucion**. Plani u rishikua në vlerën **68,660 mijë lekë** i detajuar për kryerjen e punimeve në nivel mirëmbajtje në 3 gjykata. Kjo bëri që shpenzimet mesatare për njësi të rishikohen në **22,887 mijë lekë/institucion**. Fondi është realizuar në vlerën **63,592 mijë lekë** nga 3 gjykata. Shpenzimet mesatare për njësi janë **21,197 mijë lekë/institucion**. Shpenzimet mesatare (kostoja mesatare)

për çdo institucion në fund të viti janë më të larta në krahasim me planin fillestare me rreth 48 %, por janë ulur në masën 7% në krahasim me planin e rishikuar.

3- Produkti:18AD801“Blerje pajisje zyre ” -Njësia matëse – nr. institucioni.

Për vitin 2022 u detajua fondi për mobilje dhe pajisje për zyra dhe salla gjyqi pajisje sigurie dhe pajisje të tjera për 25 gjykata, në vlerën **29,500 mijë lekë**, ose mesatarisht 1,180 mijë lekë/institucion. Buxheti për këtë produkt është rishikuar në vlerën **23,140 mijë lekë** i detajuar për 21 gjykata ose mesatarisht **1,052 mijë lekë /institucion**. Gjatë vitit, nga 22 gjykatat shpenzuan për blerje pajisje zyre **23,068 mijë lekë**, ose secila gjykatë shpenzojë mesatarisht **1,049 mijë lekë/njësi**. Në fund të vitit shpenzimet mesatare për institucion në këtë produkt nuk kanë ndryshuar kundrejt planit të rishikuar, ndërsa kundrejt planit të fillimit të vitit janë ulur mesatarisht në masën **11%**.

4- Produkti: 21AC401 -“Blerje Pajisje” - Njësia matëse - nr. institucioni.

Për këtë produkt u detajua në fillim të vitit fondi në vlerën **39,200 mijë lekë**, për 26 gjykata, ose mesatarisht **1,508 mijë lekë/gjykatë**. Buxheti për këtë produkt është rishikuar në vlerën **26,445 mijë lekë**, i detajuar për 21 gjykata, ose mesatarisht **1,259 mijë lekë** për gjykatë. Gjatë vitit u realizua fondi nga 20 gjykata në vlerën **19,247 mijë lekë**, ose u shpenzuan mesatarisht **962 mijë lekë/institucion** për blerje pajisje. Kjo ka sjellë që shpenzimet mesatare në fund të vitit për këtë artikull janë ulur në masën 36% krahasur me planifikimin fillestar dhe 24% krahasuar me planin e rishikuar.

5- Produkti M29066 “ Studime dhe Projektme” - Njësia matëse - nr. Projektsh

Në fillim u planifikuan **10,000 mijë lekë** për realizimin e hartimit të një projekti. Gjatë vitit, buxheti u rishikua në vlerën **2,000 mijë lekë** po për hartimin e 1 projekti. Ka përfunduar hartimi i projektit në vlerën 1,599 mijë lekë. Shpenzimet mesatare/njësi në fund të vitit të janë 84% më të ulta se planifikimi fillestar dhe 20% më të ulta se buxheti i rishikuar.

6- Produkti: 21AC501 “Programe Software”- Njësia matëse -nr programesh.

Në fillim të vitit u planifikua fondi për blerjen e 4 programeve software nga KLGJ (programi 03310) në vlerën **231,600 mijë lekë** ose mesatarisht u planifikua të shpenzoheshin **57,900 mijë lekë për program**. Gjatë vitit ky produkt u rishikua në vlerën **240,051 mijë lekë** i detajuar për 5 programe software, ose mesatarisht nisur nga njësia matëse **48,010 mijë lekë /njësi**. Gjatë vitit për realizimin e këtij produkti dy institucionet kanë shpenzuar për prokurimin e 5 programeve **203,185 mijë lekë/njësi**, ose mesatarisht janë shpenzuar **40,637 mijë lekë/njësi**. Kjo ka sjellë që shpenzimet mesatare /njësi, krahasuar me planifikim fillestare të jenë ulur në masën 30% dhe 15 % krahasuar me planin e rishikuar.

7- Produkti:M290075 “Blerje mjete motorike” -Njësia matëse – nr. mjetesht.

Në fillim të viti u planifiku fondi në vlerën 15,000 mijë lekë për blerjen e 5 automjeteve dhe 6 motoçikleta. Fondi ishte planifikuar 14,100 mijë lekë për blerjen e 5 automjeteve ose **2,820 mijë lekë/njësi** dhe 900 mijë lekë për prokurimin e 6 motoçikletave ose mesatarisht **150 mijë lekë/njësi**. Buxheti u rishikua në **12,204 mijë lekë** për blerjen 4 automjeteve dhe **732 mijë lekë** për blerjen e 6 motoçikletave. Gjatë vitit u realizu fondi në vlerën 12,204 mijë lekë, nga të cilat; **11,472 mijë lekë** për blerjen e 4 automjeteve dhe **732 mijë lekë** për blerjen e 6 motoçikletave. Shpenzimet mesatare në fund të vitit janë 2,868 mijë lekë/automjet dhe 122 mijë lekë/ për

motoçikletë. Sikurse duket shpenzimet mesatare për blerjen e automjeteve janë ritur me 2% kundrejt planifikimit fillestarë dhe 1% kundrejt plani të rishikuar. Ndërsa shpenzimet mesatare për blerjen e motoçikleve janë ulur me 19% kundrejt planifikimit fillesatare dhe atij të rishikuar.

Në aneksin nr. 3, në një tabelë të veçantë, janë pasqyruar edhe treguesit e performancës/produkteve të realizuara nga përdorimi i të ardhurave jashtë limitit.

Produkti: 92902AA - “Çështje të gjykuara në vit”- Njësia matëse - nr.çështjesh.

Përveç fondeve buxhetore gjykatat kanë përdorur edhe të ardhurat e tyre. Gjatë vitit janë shpenzuar rreth 18,285 mijë lekë nga të ardhurat, për realizimin e çështjeve.

Produkti 21AC401- “ Blerje pajisje ”- Njësia matëse - nr.institucionesh.

Gjatë vitit 2022, përveç shpenzimeve të kryera nga 20 gjykata me fondet buxhetore, 3 prej tyre kanë përdorur, edhe të ardhurat e arkëtura për blerjen e pajisjeve elektronike në vlerën **290 mijë lekë**, për të plotësuar nevojat e gjykatave.(pra janë në total $20+3=23$).

Produkti 18AD801-“Blerje Pajisje Zyre”- Njësia matëse – nr.institucioni.

Gjatë viti 2022, përveç shpenzimeve të kryera për këtë produkt nga 22 gjykata, janë prokuruar gjithashtu pajisje zyre nga të ardhurat krijuara nga gjykata në vlerën **4,625 mijë lekë** prej 19 gjykatave. Nga këto; 9 prej tyre janë gjykata të cilat janë pjesë e 22 gjykatave të cilat përveç fondeve buxhetore kanë përdorur edhe të ardhurat. Ndërsa 10 gjykatat e tjera këtë produkt e kanë realizuar vetëm nga të ardhurat. Në këtë aspekt në total gjykatat që kanë prokuruar këtë produkt janë $22+10=32$ gjykata.

Produkti: M290066 “studime dhe projekte” - Njësia matëse – nr.institucioni

Gjatë vitit 2022 nga të ardhurat e arkëtura 1 gjykata kanë kryer shpenzime për hartim projektin në vlerën 384 mijë lekë . Ky numër i shtohet numrit të (1 gj) gjykatës që ka kryer shpenzime për hartimin e projekteve. Në total gjykatat që kane prokuruar këtë produkt janë $1+1=2$ gjykata.

Pothuajse në të gjitha produktet vihet re një ulje e kostos për njësi në fund të vitit raportues, krahasuar me atë në fillim të vitit. Kjo ka ardhur si rezultat i rishikimit të fondeve buxhetore (pakësimit të fondeve buxhetore me aktet ligjore), por edhe kujdesjes nga ana e gjykatave dhe KLGJ-s, për të menaxhuar me efikasitet dhe efikasitet fondet buxhetore. Ritja e shpenzimeve mesatare për çështje ka të bëjë me vakancat në sitemin gjyësor.

Ankesi nr.4 - Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit” për vitin 2022.

I.- Programi 01110- “Planifikim, menaxhim dhe administrim” synon garantimin e funksionimit normal të aktivitetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke forcuar panvarësinë, efikasitetin, transparencën, me qëllim që gjyqësori të meritojë besimin e publikut.

Qëllimi: “Përmirësimi i Sistemit Gjyqësor nëpërmjet vendimmartjes së Këshillit lidhur me miratimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjeve që përbëjnë paketën e reformës në drejtësi si dhe sigurimin e burimeve dhe kapaciteteve financiare të nevojshme”.

Objektiv 1: “KLGJ-ja do të angazhohet në vendosjen e standardeve të larta të kapaciteteve njerëzore dhe institucionale të saj dhe për përmirësimin e performancës së gjyqësorit në të tre nivelet”

Treguesit e performancës për këtë objektiv janë si më poshtë:

- 1) Akte nënligjore të hartuara dhe miratuara nga KLGJ-ja kundrejt totalit të vendimeve të marra, në masën 75%. Realizimi i treguesit për periudhën raportuese është 2%, ndërsa përqindja e realizimit të treguesit të performancës kundrejt nivelit të planifikuar është në masën 3%. Nga 607 vendime të marra gjithsej nga KLGJ-ja gjatë vitit 2022, vetëm 10 prej tyre, ose 2 %, janë aktet nënligjore të miratuara prej saj.
- 2) Përqindja e punonjësve të KLGJ-së, të trajnuar në masën 60%. Realizimi i treguesit për periudhën raportuese është 24%, ndërsa përqindja e realizimit të treguesit kundrejt nivelit të planifikuar është në masën 39%. Gjatë këtij viti rezultojnë 25 nëpunës të Këshillit të Lartë Gjyqësor të cilët janë trajnuar nga ASPA, sipas nevojave specifike të pozicionit të punës. Gjithashtu, gjatë vitit 2022 janë zhvilluar trajnime nga Drejtoria e Programimit dhe Monitorimit të Buxhetit, nga Drejtoria e Mardhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet pranë KLGJ-së dhe Qendra ALTRI, sipas nevojave për trajnim të nëpunësve civil gjyqësor.
- 3) Përqindja e stafit administrativ dhe administrativ gjyqësor të rekrutuar në masën 80%.

Realizimi i treguesit është 7% ndërsa përqindja e realizimit të treguesit të performancës kundrejt nivelit të planifikuar është 9%. Për vitin 2022, numri i punonjësve të KLGJ-së, i miratuar me ligj është 1,729 vetë, ndërsa organika faktike në muajin janar ishte 1,462 vetë, pra kishte mungesa me 267 vetë. Në fund të vitit vakancat e përhershme janë 1,482 vetë pra ka patur mungesa me 247 vetë, pra mesatarisht janë plotësuar 20 vende nga 267 që ishin mungesat. Pra niveli faktit i këtij treguesi është 7% ($7/267*100$) =7% , ndërsa % e realizimit të treguesit kundrejt nivelit të planifikuar është 9%. Edhe pse treguesi është në nivel të ulur duhet theksuar që KLGJ dhe gjykatat kanë kryer procedura rekrutimi si me poshte :

KLJGJ ka kryer 22 procedura konkurrimi për 23 pozicione dhe kanë përfunduar me sukses 17 prej tyre. QTI ka kryer 3 procedura për 5 pozicione por pa fitues. Në gjykata, janë shpallur procedura për 155 pozicione në shërbimin civil gjyqësor, dhe 124 prej tyre kanë përfunduar me sukses osë 80% e tyre. Gjatë vitit janë emëruar gjithashtu edhe 80 punonjës me kod pune. Duhet thënë që edhe pse kanë përfunduar pozitivisht pjesa më e madhe e procedurave të rekrutimit, një pjesë e tyre janë lëvizje paralele ose ngritje në detyrë brenda sistemit gjyqësor pra nuk janë prurje të reja ndërkohë që ka patur edhe largime nga sistemi gjyqësor dalje në pension pleqërie, të cilat kanë sjellë që në total numri i vakancave të plotësuar të jetë 20 vetë.

- 4) Magjistratë të vlerësuar kundrejt totalit të magjistratëve në masën 70%.

Realizimi i treguesit për periudhën raportuese është në masën 6%, ndërsa përqindja e realizimit të treguesit të performancës, kundrejt nivelit të planifikuar është në masën 9% Nga 318 magjistratë në fakt, gjatë kësaj periudhe janë vlerësuar me të dyja vlerësimet 18 magjistratë ose 6% e tyre.

- 5) Numri i magjistratëve të emëruar, transferuar, promovuar dhe shkarkuar kundrejt totalit të përgjithshëm të magjistratëve në masën 60%.
- 6) Nga 318 magjistratë në fakt; janë propozuar dhe emëruar në Gjykatën e Lartë 24 magjistratë nga të cilët 23 janë që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2022 dhe 1 magjistratë nga rradhët e juristëve të spikatur ; 17 magjistratë kanë patur ngritje në detyrë,

janë transferuar në mënyrë të përkohshme 9 magjistratë dhe janë shkarkuar 48 magjistratë. Pra në total 98 magjistratë ose 31% e totalit prej 318 magjistratësh. Për vitin 2022, % e realizimi të treguesit, kundrejt nivelit të planifikuar është në masën 52%.

- 7) Përqindja e gjykatave të audituara, për vitin 2022 në masën 80%. Për vitin 2022 janë kryer 12 auditime nga 13 të planifikuar ose 90% e planit. Niveli faktik i realizimit të treguesit është 90% ndërsa përqindja e realizimit të treguesit të performancës kundrejt nivelit të planifikuar është në masën 113%.

Masa e realizimit të treguesve të mësipërm është e lidhur me 3 produkte, realizimi i të cilave është si më poshtë:

Produkti 92901AA: -“Numri i vendimeve të marra nga KLGJ-ja”- Njësia matëse-nr.vendimesh.

Për vitin 2022, janë parashikuar të merren 600 vendime nga KLGJ-ja. Gjatë viti 2022, janë marrë 562 vendime. Ky produkt është realizuar në masën 94%. Realizimi është i lidhur me mungesat në strukturën organike të KLGJ –së.

Projekti M290072 - “Blerje Pajisje” Njësia matëse - nr.institucioni.

Fondi është realizuar në terma sasior në masën 100%.

Projekti 18AD805 - “ **Programe software**” Njësia matëse - nr.institucioni.

Fondi është realizuar në terma sasior në masën 100%

Qëllimi i programit 01110 –“ Planifikim, menaxhim dhe administrim”, për vitin 2021, është realizuar në masën 91%

II- Programin 01140 “Mbështetje për teknologjinë, e sistemit të drejtësisë” synon caktimin e standardeve dhe politikave, në përputhje me rregullat për politikën e përgjithshme shtetërore për sistemin e teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë, për një funksionim efektiv të sistemeve të teknologjisë së punimit të informacionit dhe të të dhënave (pajisje dhe programe), duke siguruar përmbushjen e nevojave të institucioneve të sistemit të drejtësisë.

Qëllimi: Përcaktimi i prioriteteve, politikave, dhe standardeve, në lidhje me sistemin e teknologjisë së informacionit në sistemin e drejtësisë.

Objektivi: Angazhimi i QTI-së, për garantimin e arritjes së standardeve të BE-së, për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit.

Treguesi i performancës për këtë objektivi është:

Përmirësimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit në sistemin e drejtësisë, në masën 50%.

Për realizimin e këtij treguesi është përcaktuar si produkt;

Produkti 92903AA: “Programe dhe pajisje të STI-së”, Njësi matëse – nr. sistemesh.

Produkti është realizuar tërësisht nisur nga njësia matëse, por në vlerë është realizuar pjesërisht.

Qëllimi i programit 01140 “Mbështetje për teknologjinë, e sistemit të drejtësisë ” është realizuar në masën 46%.

III.- Programi 03310 “Buxheti Gjyqësor”, synon ofrimin efikas të shërbimeve dhe funksionim më të mirë të gjykatave nëpërmjet mbështetjes buxhetore të shërbimeve gjyqësore dhe përmirësimit të infrastrukturës, me qëllim sjelljen e tyre në parametrat dhe cilësinë e performancës së ngjashme me vendet e BE-së.

Qëllimi: Ofrimi efikas i shërbimeve dhe punë më e mirë në gjykatat e 3 niveleve.

Objektivi 1: "Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve përmes novacionit dhe forcimit të strukturave dhe sistemeve të teknologjisë, që zhvillojnë koherencën, efikasitetin dhe efektshmërinë institucionale

Treguesit e performancës për këtë objektivi janë si më poshtë:

- 1) Vlerësimi dhe përmirësimi i infrastrukturës gjyqësore (ndërtesa, mjedise pune etj), për të garantuar standarde bashkëkohore në përmbushjen e detyrave kushtetuese dhe ofrimin dinjitoz të shërbimit për publikun, në masën 65%. Realizimi i treguesit për periudhën raportuese është **62%**, ndërsa përqindja e realizimit të treguesit të performancës kundrejt nivelit të planifikuar është **96%**
- 2) Përmirësimi, ose ngritja e sistemeve të teknologjisë së informacionit, të cilat përmbushin standardet ndërkombëtare dhe rrisin efikasitetin në ofrimin e shërbimeve, sipas ritmeve të ndryshimeve të teknologjisë, në masën 96%. Realizimi i treguesit për periudhën raportuese është **94%**, ndërsa përqindja e realizimit të treguesit të performancës kundrejt nivelit të planifikuar është në masën **98%**.

Përqindja e realizimit të treguesit i referohet vlerës mesatare të përqindjes së realizimit të treguesve në terma sasior të 5 produkteve:

1. Produkti 92902AA - “Çështje të gjykuara” Njësia matëse- nr çështjesh.

Për vitin 2022, u planifikuan të realizohen rreth **162,514** çështje, janë realizuar nga gjykatat **131,865** çështje, ose në masën **81%**. Mosrealizimi ka ardhur si rezultat i mungesave në sistemin gjyqësor, sikurse u citua më lart.

2. Produkti M29066 - “ Studime dhe projekttime” - Njësia matëse- nr projektesh .

Gjatë viti 2022 në këtë produkt sipas buxhetit të rishikuar ishte planifikuar 1 projekt dhe është realizuar plotësisht në masën **100 %**.

3. Produkti:18AD801 - “Blerje pajisje zyre” Njësia matëse – nr institucioni.

Sipas buxhetit të rishikuar të viti 2022 ky produkt u rishikua për 22 gjykata dhe është realizuar nga 22 gjykatat, ose në masën **100%**.

4. Produkti M290068 - “Rikonstruksione të tjera ndërtimore” Njësia matëse – nr institucioni.

Produkti u rishikua gjatë vitit për 3 gjykata dhe u realizua nga të 3 gjykatat ose në masën **100%**.

5. Produkti M290075 - “Blerje Mjete Motorike ” Njësia matëse – nr mjetesh.

Sipas buxhetit të rishikuar fondi i detajuar për 4 automjete dhe 6 motoçikleta është realizuar plotësisht në masën 100%.

Masa e realizimit në % për çdo produkt reflekton realizimin e produkteve në terma sasior, konkretisht raportin për njësi matëse të çdo produkti të realizuar kundrejt planit vjetor të

rishikuar. Përqindja mesatare e realizimit të këtyre 5 produkteve është 96% e cila reflektohet edhe në masën e realizimit të treguesit të performancës nr.1

6. Produkti 18AD805 - “Blerje softwarë” Njësia matëse - nr programesh.

Për vitin 2022 u planifikua fondi për blerjen e 4 programeve softwarë nga KLGJ (Fondi i detajuar në programin 03310);

Gjatë vitit 2022, ky produkt u rishikua duke u planifikuar për 2 institucione (KLGJ+ Gj. E Lartë) dhe numri i programeve u bë 5 programe softwarë në total. Fondi u përdor për prokurimin në total, të 5 programeve nga të cilat; (KLGJ) *1-Projekti Disaster Recovery ;2-Projekti Dixhitalizimi i Arkivës Gjyqësore ;3-Regjistri Elektronik Kombëtar të OJF-ve ;4-Sistemi i ri elektronik i menaxhimit të çështjeve gjyqësore. + (Gj, së Lartë) 1 -Projekti Disaster Recovery, ose në masën 100%.*

7. Produkti: M290072 -“Blerje Pajisje” Njësia matëse – nr institucioni.

Për vitin 2022, ky produkt, u planifikua në **21** gjykata dhe është realizuar në **20** prej tyre, ose në masën **95%**. Mosrealizimi nga 1 gjykatë ka ardhur si rezultat i ankimimit në K.P.P nga një Operatori Ekonomik. Kjo solli bllokimin e procedurës dhe anulimin e saj.

Përqindja mesatare e realizimit të këtyre dy produkteve është 98% e cila reflektohet edhe në masën e realizimit të treguesit të performancës nr. 2

Masa e realizimit në % për çdo produkt reflekton realizimin e produkteve në terma sasior, konkretisht raportin për njësi matëse të çdo produkti të realizuar kundrejt planit vjetor të rishikuar.

Qëllimi i programit 03310 –“Buxheti Gjyqësor”, për vitin 2022, është realizuar në masën **93%** referuar buxhetit të rishikuar vjetor. Kjo pasqyron një përdorim me eficence dhe efektivitet të fondeve buxhetore.

Aneksi nr. 5- Raporti i projekteve me financim të brendshëm për vitin 2022

Detajimi i fondeve buxhetore të miratuara për vitin 2022, në shpenzime kapitale (investime) sipas grupeve të investimeve dhe kodit të projektit, u krye duke mbajtur në vëmendje; nevojat e përvitshme të shpenzimeve për pajisje elektronike, programe e sisteme softëare, të cilat garantojnë funksionimin normal dhe mënjanojnë riskun e ndërprerjes së funksionimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, nevojat për pajisje zyre, kryesisht zëvendësimin e atyre të amortizuara dhe nevojat shtesë të lindura, plotësimin e nevojave për pajisje sigurie, plotësimin e nevojave për rikonstruktionet e pjesshme sipas kërkesave të gjykatave.

Fondi i akorduar për vitin 2022 në shpenzime kapitale, për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor” është në total **412,000 mijë lekë**. Nga të cilat **15,000 mijë lekë** në programin 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim” dhe **397,000 mijë lekë** në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”.

Gjatë vitit 2022, fondi në investime është pakësuar më Aktin Normativ nr 17 datë 01.12.2022 në vlerën 27,000 mijë lekë, nga të cilat 2,500 mijë lekë, në programin 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim” dhe 24,500 mijë lekë në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”. Buxheti i rishikuar vjetor është **385,000 mijë lekë** dhe është realizuar në total si grup buxhetor në vlerën **333,744 mijë lekë** ose në masën **87%**.

I - Programi - 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim”

Për programin 01110- “Planifikim, menaxhim dhe administrim” për vitin 2022, u planifikuan të realizohen 2 projekte në vlerën totale **15,000 mijë lekë** i detajuar 14,160 mijë lekë në projektin M290072 “Blerje pajisje” dhe 840 mijë lekë në projektin 18AD805 “Programe Software”. Me Aktin Normativ nr. 17 datë 01.12.2022, fondi në investime për këtë program u pakësua në vlerën 2,500 mijë lekë nga të cilat; u pakësuan 97 mijë lekë nga projekti 18AD805 “Programe softëare” dhe 2,403 mijë lekë nga projekti M290072 “Blerje Pajisje”.

Buxheti i rishikuar vjetor është 12,500 mijë lekë i detajuar në ;

-Projekti - M290072 “Blerje Pajisje” në vlerën 11,757 mijë lekë.

-Projekti – 18AD805 “ Programe softëare” në vlerën 743 mijë lekë.


Pasqyra- Detajimi i fondeve buxhetore, sipas grupeve investimeve dhe kodit të projektit për programin 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim”

000 lekë

Nr.	Projekti	Kodi i projektit	Buxheti i rishikuar vjetor 2022	Realizimi për vitin 2022	% e realizimit vjetor
1	Blerje pajisje	M290072	11,757	10,107	86%
2	Programe Software	18AD805	743	743	100%
	Totali		12,500	10,849	87%

Paraqitja grafike e realizimit të fondit në investimeve per vitin 2022, programi 01110

000/lekë



1- Projekti M290072 “Blerje pajisje ”

Për këtë projekt është parashikuar fondi në vlerën **11,757 mijë lekë**. Ky fond ka shërbyer për plotësimin e nevojave të KLGJ-së me;

- “*Instalim dhe pajisje telekomunikacioni*” (Server).
- “*Instalim i sistemit të kompjuterave*” (Programe software), për ristrukturimin e portalit të KLGJ-së.
- “*Pajisje të tjera teknike*” (Switch Layer 3, Storage per server, Firëwall, aksesore, etj).
- “*Pajisje kompjuterike*” (Kompjuter, laptop)
- “*Orendi zyre*”, sipas nevojave të identifikuar dhe adaptimit të disa ambjenteve në zyra.
- “*Blerje libra-fond biblioteke*”, si libra juridikë, kode të fushës së jurisprudencës dhe botime të tjera nga QBZ.
- “*Pajisje tjera zyre*”, si scaner, grirëse letre, diktofon, sëitch, kamera, aparat fotografik, etj. Është është likujduar fondi në vlerën 10,107 mijë lekë, ose në masën 86%.

2- Projekti 18AD805 “Programe Software”.

Është planifikuar fondi në vlerën **743 mijë lekë**, për blerje patenta softëare për ristrukturimin e portalit të KLGJ-së. Këshilli ka përfunduar procedurën në vlerën 743 mijë lekë ose në masë 100%.

Në total në këtë program fondi në investime në vlerën **12,500 mijë lekë** është relizuar në vlerën **10,849 mijë lekë**, ose në masën reth 87% .

II - Programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”

Për programin 03310 “Buxheti Gjyqësor” për vitin 2022 ishin planifikuar të realizoheshin 6 projekte, në vlerën totale **397,000 mijë lekë**. Gjatë vitit fondi në këtë program u pakësua me Aktin Normativ nr.17 datë 01.12.2022, në vlerën 24,500 mijë lekë, vlera e buxhetit të rishikuar vjetor për këtë program për vitin 2022, është **372,500 mijë lekë**. Pakësimet me aktin normativ, janë reflektuar edhe me ndryshimin e vlerës së secilit projekt si më poshtë:

Projekti 18AD801 “Blerje Pajisje”, pakësuar fondi në vlerën **6,800 mijë lekë** i detajuar në 20 gjykatave, buxheti i rishikuar vjetor në këtë projekt është **23,140 mijë lekë**

Projekti 21AC401 “Blerje pajisje elektronike”, pakësuar fondi në vlerën **2,787 mijë lekë**, nga 18 gjykata, buxheti i rishikuar vjetor në këtë projekt është **26,445 mijë lekë**.

Projekti 21AC501- “Programe software”, pakësuar fondi në vlerën **1,245mijë lekë** për 2 gjykata. Buxheti i rishikuar vjetor është **240,051mijë lekë**

Projekti M290068- “Rikonstruksion”, pakësuar fondi në vlerën **13,668 mijë lekë**. Buxheti i rishikuar vjetor në këtë projekt është **68,660 mijë lekë**.


Pasqyra- detajimi i fondeve buxhetore në investime sipas kodit të projektit dhe realizimit faktik

000 lekë

Kodi i projektit	Emërtimi i projektit	Buxheti i rishikuar për vitin 2022	Realizimi i fondeve për vitin 2022	% e realizimit
M290066	Studime dhe Projektme	2,000	1,599	80%
21AC501	Programe Softwarë	240,051	203,185	85%
M290068	Ndërtim i ri dhe Rikonstruksion i plotë/ pjesëshëm,	68,660	63,592	93%
21AC401	Blerje pajisje elektronike,	26,445	19,247	73%
18AD801	Blerje pajisje zyre	23,140	23,068	100%
M290075	Blerje mjete motorike	12,204	12,204	100%
	Totali	372,500	322,894	87%

Paraqitja grafike e realizimit të fondit në investimeve për vitin 2022, programi 03310

000 lekë



1) Projekti M290066 “Studime dhe Projektme”.

000/lekë

Emërtimi	Kodi i Projektit	Plani vjetor në fillim të vitit 2022	Plani i rishikuar vjetor 2022	Realizimi për vitin 2022	% e Realizimit
Studime dhe projektme	M290066	10,000	2,000	1,599	80%

- ✓ Buxheti vjetor i alokuar në këtë projekt , në fillim të vitit, ishte **10,000 mijë lekë** i detajuar për Gjykatën e Lartë. KLGJ. Në zbatim të vendimit të KLGJ-së nr. 596, datë 23.12.2021,

“Për detajimin e fondeve buxhetore, në sistemin gjyqësor, për vitin 2022”, me shkresën nr.736 , datë 04.02.2022, drejtuar MFE-së, kërkoi transferimin e fondit në vlerën **19,000 mijë lekë** nga projekti **M290068 “Ndërtim i ri dhe rikonstruksion i plotë / i pjesshëm”** i detajuar për Gjykatën e Lartë (**artikulli 231**), në projektin **M290066 “Studime dhe Projekttime” (artikulli 230)** të kësaj gjykate. MFE me shkresën nr. 2130, datë 02.03.2022 ka miratuar këtë transferim. Në vijim me kërkesë të KLGJ-së, me shkresën nr. 1731 , datë 04.03.2022, miratuar nga MFE me shkresën nr 4457/1, datë 07.04.2022, fondi në vlerën **29,000 mijë lekë** i detajuar në projektin M29066 “Studime dhe Projekttime” të Gjykatës së Lartë, u transferua në programin 03310, të KLGJ-së. Fondi në vlerën **29,000 mijë lekë** do të përdorej për hartimin e projektit për ndërtimin e godinës së re të Gjykatës së Lartë. Projekti nuk u realizua, pasi, nga Bashkia e Tiranës nuk është vënë në dispozicion shesh ndërtimi (truall), edhe pas kërkesave të KLGJ-së si hap i parë dhe i domosdoshëm për fillimin e hartimit të Projektit të Zbatimit për ndërtimin e godinës së re të Gjykatës së Lartë. Fondi u transferua me kërkesë të KLGJ-së dhe miratuar nga MFE me shkresën nr nr.17318/1 date 23.09.2022. Fondi i pakësuar në vlerën 29,000 mijë lekë u transferua në dy projekte të tjera; fondi në vlerën 23,800 mijë lekë u transferua në projektin M290068 “ Rikonstruksion” për realizimin e rikonstruksionin të bodrumeve të katit të I –rë të godinës së Gjykatës së Apelit Tiranë sipas projektit të realizuar, ndërsa diferenca u transferua në programin 03310 të KLGj-së në projektin 21AC501 “Programe Softëare”.

✓ Në muajin korrik me miratimin e hartës së re gjyqësore u vendos data 1 shkurt 2023, si data e shkrirjes së gjykatave të apelit në rrethe dhe transferimit të aktivitetit të tyre në Gj. Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e cila do të akomodojë një numër të madh gjyqtarësh dhe stafi administrativ. Për këtë arsye gjykata kërkoi një fond shtesë në vlerën **2,000 mijë lekë**, për të realizuar hartimin e projektit për riparimin e rrjetit kompjuterik dhe elektrik si dhe rikonstruksionit të bodrumeve të katit të I –rë të kësaj godine. Me shkresën nr.37778 datë 01.07.2022, të KLGJ-së dhe miratuar nga MFE me shkresën nr 13029/1 datë 25.07.2022, është miratuar transferimi.

Buxheti i rishikuar vjetor në këtë projekt është **2,000 mijë lekë**. Gjykata ka përfunduar realizimin e hartim- projektit në vlerën **1,599 mijë lekë** ose në masën reth 80%. Diferenca është terpicë nga prokurimi online.

2) Projekti 21AC501 “Programe software”.

000/lekë

Emërtimi	Kodi i Projektit	Plani vjetor në fillim të vitit 2022	Plani i rishikuar vjetor 2022	Realizimi për vitin 2022	% e Realizimit
Programe software	21AC501	231,600	240,051	203,185	85%

Në fillim të vitit u planifikua në këtë projekt fondi në vlerën **231,600 mijë lekë**, i detajaur në programin 03310 të KLGj-së. Gjatë viti fondi është rishikuar si rezulta i rishpërndarjes së fondeve nga projektet e tjera në total në vlerën 9,696 mijë lekë dhe në vijim me pakësimin e tij me aktin normativ në vlerën **1,245 mijë lekë**. Buxheti i rishikuar në këtë projekt është **240,051 mijë lekë** nga të cilat; **238,375 mijë lekë** në programin 03310 të KLGJ dhe **1,676 mijë lekë** për Gjykatën e Lartë.

a) Në muajin shtator fondit të planifikuar në fillim të vitit në vlerën 231,600 mijë lekë i detajuar në programin 03310 të KLGJ-së, ju shtua fondi në vlerën 5,996 mijë lekë nga të cilat 5,200 mijë lekë nga projekti M290066 si dhe teprica në vlerën 2,796 mijë lekë nga prokurimi online i fondit të projektit M290075. Fondi i rishikuar vjetor si rezultat edhe i pakësimit (në vlerën 1.221 mjë lekë) në këtë projekt është 238,375mijë lekë.

Fondi ka shërbyer për realizimin e projekteve të mëposhtme;

1-Projekti Disaster Recovery ;2-Projekti Dixhitalizimi i Arkivës Gjyqësore ;3-Regjistri Elektronik Kombëtar të OJF-ve ;4-Sistemi i ri elektronik i menaxhimit të çështjeve gjyqësore.

KLGG, ka kontraktuar fondin në vlerën **238,334 mijë lekë**, ose 100% e fondit dhe e ka realizuar atë në vlerën **201,509 mijë lekë**, ose në masën **85%**. Diferenca ka të bëjë me faturën e shpenzimit të muajit dhjetor që do të likujdohet në muajin janar 2023.

b) Në muajin maj, Gjykata e Lartë i kërkoi KLGJ-së, që fondet e papërdorura të saj në projektin 21AC401, në vlerën 1,700 mijë lekë, të transferohen në projektin 21AC501 të po kësaj gjykate. Mbështetur në kërkesën e KLGJ-së nr. 2850 datë 18.05.2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën 9123/1, datë 22.06.2022 ka miratuar këtë transferim. Fondi në vlerën 1,700 mijë lekë i Gjykatës së Lartë është përdorur për realizimin e *Projekti Disaster Recovery* të kësaj gjykate. Gjykata ka realizuar plotësisht fondin në vlerën **1,676 mijë lekë**. Diferenca e mbetur nga prokurimi online u pakësua me aktin normativ të sipër Në total projekti është realizuar në masën 100%.

Projekti 21AC 501 është realizuar në total për dy institucionet në vlerën **203,185 mijë lekë**, ose në masën **85%**.

3) Projekti M290068 - “Ndërtim i ri dhe Rikonstruksion i plotë/ pjesshëm,”

000/lekë

Emërtimi	Kodi i Projektit	Plani vjetor në fillim të vitit	Plani i rishikuar vjetor	Realizimi për vitin 2022	% e Realizimit
Ndërtim i ri, Rikonstruksion i plotë/i pjesshëm	M290068	71,700	68,660	63,592	93%

Vlera e fondit të planifikuar në këtë projekt në fillim të vitit ishte **71,700 mijë lekë** i detajuar për 5 gjykata. Gjatë vitit fondi në këtë projekt është rishikuar:

- Me shkresën nr.736 , datë 04.02.2022, drejtuar MFE-së kërkoi transferimin e fondit (pakësimin) në vlerën **19,000 mijë lekë** nga projekti **M290068 “Ndërtim i ri dhe rikonstruksion i plotë / i pjesshëm”** i detajuar për Gjykatën e Lartë (**artikulli 231**) në (shitesë) projektin **M290066 “Studime dhe Projektme” (artikulli 230)**, të kësaj gjykate.

- Me shkresën 3778 prot datë 01.07.2022,drejtuar MFE -së, kërkoi transferimin e fondit (shitesë) në vlerën në vlerën **5,828 mijë lekë** nga fondet e lira të krijuara në projektin 21AC401(*Blerje pajisje*) në projektin **M290068 “Ndërtim i ri dhe rikonstruksion i plotë”** për plotësimin e nevojave të Gj.Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- Me kërkesë të KLGJ-së dhe miratuar nga MFE me shkresën nr.17318/1 date 23.09.2022, u transferua në këtë projekt fondi në vlerën 23,800 mijë lekë, për realizimin e punimeve në nivel mirëmbajtje për riparimin e rrjetit kompjuterik dhe elektrik si dhe rikonstruksionit të bodrumeve të katit të I –rë të kësaj godine.

- Pakësimi i fondit në zbatim të Aktit Normativ nr 17, datë 01.12.202, në vlerën **13,668 mijë lekë**.

Buxheti i rishikuar vjetor është **68,660 mijë lekë**, ndërsa realizimi është 63,592 mijë lekë ose në masën 92.6%

Fondi i rishikuar në vlerën **68,660 mijë lekë**, është planifikuar për kryerjen e punimeve në nivel mirëmbajtje në godinat ekzistuese të 3 gjykatave; Gjykata e Lartë në vlerën 23,952 mijë lekë, Gjykata e Apelit Tirane në vlerën 22,800 mijë lekë dhe Gj.Rr. Gjyqësor Tiranë në vlerën 21,908 mijë lekë.

1. *Gjykata e Lartë* - Për këtë gjykatë, është detajuar fondi në vlerën **23,952 mijë lekë** për punime në nivel mirëmbajtje për rikonstruksionin e tualeteve të amortizuara, ndërrimin e shtresave të pllakave në ambientet e gjykatës, të dyerve të zyrave të gjyqtarëve dhe administratës, termoizolimim e tarracës, ndriçimin e sallave të gjyqeve etj, si dhe rikonstruksionin e rrjetit kompjuterik Lan, për shkak të strukturës së komplikuar arkitektonike të godinës dhe shtimit të vendeve të punës për përdorimin e rrjetit Lan. Është kontraktuar fondi në vlerën **23,681 mijë lekë** dhe është likujduar plotësisht vlera e kontraktuar ose realizuar në masë 100%.
2. *Gjykata e Apelit Tiranë* - Në muajin korrik me miratimin e hartës së re gjyqësore u vendos data 1 shkurt 2023, si data e shkrirjes së gjykatave të apelit në rrethe dhe transferimit të aktivitetit të tyre në Gj. Apelit të Juridiksionit të përgjithshëm (GJ.Ap.Tiranë), e cila do të akomodojë një numër të madh gjyqtarësh dhe stafi administrativ. Për këtë arsye gjykata kërkoi një fond shtesë për të realizuar punimet në nivel mirëmbajtje për riparimin e rrjetit kompjuterik dhe elektrik si dhe rikonstruksionit të bodrumeve të katit të I –rë të kësaj godine. Fondi i akorduar në vlerën 22,800 është kontraktuar tërësisht në vlerën 22,487 mijë lekë, ose në masën 97% e fondit të planifikuar. Fondi është realizuar në vlerën 18,137 mijë lekë, ose në masën 79.5%. Diferenca i përket fondit të palikujduar në vlerën 4,350.6 mijë lekë e fondit të obliguar të GJ.AP. Tiranë, pasi nuk ishin dorëzuar situacione tjera shpenzimesh nga fima ndërtuese. Diferenca e palikujduar do të likujdohet brenda muajit shkurt, pasi punimet filluan vonë dhe kontrata e punimeve është zgjatur deri në 10 shkurt 2023.
3. *Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë* - Fondi i rishikuar vjetor për këtë gjykatë në vlerën **21,908 mijë lekë** është përdorur për përshtatjen e dhomës së serverit në përputhje me rregulloren e hartuar nga AKSHI. Fondi është kontraktuar dhe realizuar plotësisht në vlerën 21,775 mijë lekë ose në masën 99%.

Në total projekti M290068 në vlerën **68,660 mijë lekë** është realizuar në vlerën **63,592 mijë lekë** , ose në masën **93%**.

4) Projekti-18AD801 “Blerje Pajisje Zyre”

000/lekë

Emërtimi	Kodi i Projektit	Plani vjetor në fillim të vitit	Plani i rishikuar vjetor	Realizimi për vitin 2022	% e Realizimit
Blerje Pajisje Zyre	18AD801	29,500	23,140	23,068	100%

Për vitin 2022, fondi i planifikuar për këtë projekt ishte **29,500 mijë lekë**. Gjatë viti është rishikuar buxheti si më poshtë;

- Shtesë fondi në vlerën 440 mijë lekë, miratuar me, shkresën MFE – së, nr. 5887/1, datë 04.05.2022

- Pakësimin të fondit në vlerën 6,800 mijë lekë në zbatim të Aktit Normativ nr. 17, datë 01.12.2022.

Buxheti i rishikuar vjetor është 23,140 mijë lekë dhe është realizuar plotësisht në vlerën 23,068 mijë lekë, ose në masën 100%. Fondi ka shërbyer për plotësimin e nevojave të gjykatave me pajisje dhe orenditë të ndryshme për zyra salla gjyqi dhe ambiente të tjera të gjykatave.

5) Projekti 21AC401 - “Blerje Pajisje”

000/lekë

Emërtimi	Kodi i Projektit	Plani vjetor në fillim të vitit	Plani i rishikuar vjetor	Realizimi për vitin 2022	% e Realizimit
Blerje Pajisje	21AC401	39,200	26,441	19,247	73%

Fondi i planifikuar në fillim të vitit në këtë projekt për vitin 2022, për programin 03310-“Buxheti Gjyqësor” ishte **39,200 mijë lekë**, për plotësimin e nevojave të 26 gjykatave. Gjatë vitit buxheti në këtë projekt është rishikuar si më poshtë:

-Pakësuar fondi në vlerën 7,828 mijë lekë, miratuar pakësimi me, shkresën MFE – së, nr. 13029/1/1, datë 25.07.2022

- Pakesuar fondi në vlerën 440 mijë lekë, miratuar pakësimi me, shkresën MFE – së, nr. 5887/1, datë 04.05.2022

- Pakësuar fondi në vlerën 1,700 mijë lekë; miratuar pakësimi me shkresën e MFE-së, nr. 9123/1 datë 22.06.2022.

- Pakësuar fondi në vlerën 2,787 mijë lekë me Aktin Normativ nr17, datë 01.12.2022.

Buxheti i rishikuar vjetor është **26,445 mijë lekë**, ka shërbyer për plotësimin e nevojave të gjykatave , Fondi është realizuar në vlerën **19,247 mijë lekë** ose në masën **73%** të fondit. Nga 21 gjykata të planifikuara 20 gjykata kanë përfunduar plotësisht realizimin e fondit ndërsa fondi në vlerën 6,800 mijë lekë i Gj.së Lartë nuk mundi të realizohej për shkak të pezullimit dhe me pas anulimit të procedurës nga K.P.P. Realizimi i fondit është i lidhur me përmirësimin e infrastrukturës elektronike dhe mirëfunksionimin e sistemeve të instaluara në gjykata, i nevojshëm për të garantuar vazhdimin normal të punës si dhe për të ruajtur standardin e arritur

në drejtim të dixhitalizimit të procesit të gjykimit. Fondi është përdorur për blerjen e pajisjeve si; server, rack central telefonik, pajisje kompjuterike/laptop, pajisje fotokopje printer, UPS për PC, UPS për server, scanner, etj.

6) Projekti M290075 - “Blerje Mjete Motorike ”

000/lekë

Emërtimi	Kodi i Projektit	Plani vjetor në fillim të vitit	Plani i rishikuar vjetor	Realizimi për vitin 2022	% e Realizimit
Blerje Mjete Motorike	M290075	15,000	12,204	12,204	100%

Në këtë projekt u parashikua fondi në vlerën **15,000 mijë lekë**, i cili do shërbente për përmirësimin dhe rinovimin e mjeteve të transportit në gjykata.

- **5 “Automjeteve”** në vlerën **14,100 mijë lekë**, për plotësimin e nevojave të Gjykatës së Lartë. Fondi është prokurur në vlerën **11,472 mijë lekë** për 4 automjeteve. Rritja e cmimeve të tregut bëri të pamundur të pokuroheshin 5 automjete. KLGJ ka përfunduar realizimin e plotë të fondit të kontraktuar në vlerën **11,472 mijë lekë**.

- **6 "Motoçikleta"**, në vlerën **900 mijë lekë**, për nevojat e 4 gjykatave (Gjykata e Apelit Tiranë dhe Shkodër si dhe Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Vlorë dhe Durrës). Fondi është realizuar plotësisht në vlerën **732 mijë lekë** për blerjen e 6 motoçikletave. Diferenca në vlerën 2,796 mijë lekë (e cila përbëhet nga diferenca e prokurimit online të fondit për automjete në vlerën 2,628 dhe 168 nga vlera e fondit për motoçikleta) Diferenca u rishpërnda me kërkesë të KLGJ-së me shkresën nr 4931 datë 20.09.2022, miratuar nga MFE me shkresën nr.17318/1 date 23.09.2022.

Buxheti i rishikuar vjetor në këtë projekt është **12,204 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën 12,204 mijë lekë, ose në masën 100%.

Fondi i planifikuar në investime për vitin 2022, për grupin buxhetor është **385,000 mijë lekë**, ndërsa realizimi është **333,744 mijë lekë**, ose në masën **87%**. Diferenca e parealizuar është e lidhur me vlerën e kontraktuar plotësisht por të pa likuidur të projektive, 21AC501(KLGJ në programin 03310) dhe M29068 (Gj.Ap.Tiranë), si dhe mopërfundimi i procedurës së prokurimit të fondit nga Gj e Lartë në projektin 21AC401 dhe teprica të vogla nga prokurimi online.

Në totali fondi i akorduar për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor” është realizuar në masën **93%**. Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe gjykatat kanë bërë përpjekje maksimale për të mirëmenaxhuar fondet buxhetore në mënyrë efektive dhe eficiente.

Bashkëlidhur do të gjeni anekset e monitorimeve për të 3 programet e grupit buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit